



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORATI

Nr. 203 prot.

Gjirokastrë, më 06.02.2025

Lënda: Hapet thirrja për pjesëmarrje në Programin Erasmus+ me partneritetin COMMERCE, O'Porrino, Spanjë

Në kuadër të Programit Erasmus+, COMMERCE hap thirrjen për shkëmbim studentësh me Universitetin e Gjirokastrës.

Sipas Marrëveshjes Ndërinstitucionale, Universiteti i Gjirokastrës do të marrë pjesë me 4 (katër) studentë për mësimnxënie për një periudhë tre-mujore. Thirrja është e hapur për studentët e ciklit të parë të studimit (Bachelor) në Fakultetin Ekonomik. Gjuha e përdorur do të jetë anglisht B1 ose spanjisht B2.

Të interesuarit të dërgojnë pranë Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë dhe Kërkimit Shkencor, brenda datës **20.02.2025**, në formë fizike dhe elektronike:

- vërtetim studenti;
- listë notash;
- letër Interesi në anglisht;
- CV të detajuar mundësisht në formatin EUROPASS në anglisht;
- provë / çertifikatë të njohurive të gjuhës angleze (B1) ose spanjolle (B2);
- fotokopje të pasaportës dhe kartës së identitetit.

Dokumentacioni juaj do të vlerësohet paraprakisht nga një komision AD HOC i ngritur pranë UGJ-së dhe më pas, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë dhe Kërkimit Shkencor do t'i përcjellë nominimet te COMMERCE për vlerësimin përfundimtar të aplikantëve të cilët do të përzgjidhen.

Aplikantët duhet të jenë të përgjegjshëm dhe të respektojnë etikën, rregullat dhe orarin mësimor të institucionit pritës.

Zv/Rektore për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Kërkimin Shkencor

Prof. asoc. Merita Isaraj

